

BANKA E SHQIPËRISË

Revista Ekonomike
6M1-2024

*Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.
Botuar nga: Banka e Shqipërisë,
Sheshi "Skënderbej", nr. 1, Tiranë, Shqipëri
Tel.: + 355 4 2419301/2/3; + 355 4 2419409/10/11
Faks: + 355 4 2419408
E-mail: public@bankofalbania.org*

www.bankofalbania.org

** Pikëpamjet e shprehura në këto artikuj janë të autorëve, punonjës të Bankës së Shqipërisë, dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të institucionit.*

P Ë R M B A J T J A

*"AKSESI NË FINANCË I NDËRMARRJEVE NË SHQIPËRI: REZULTATE MBI
NDIKIMIN E NDRYSHIMIT TË MOTIT DHE KLIMËS"*

5

*Elona Dushku, Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë
Argita Frashëri, Departamenti i Statistikave Financiare, Banka e Shqipërisë
Frenki Ktona, Departamenti i Statistikave Financiare, Banka e Shqipërisë*

“AKSESI NË FINANCË I NDËRMARRJEVE NË SHQIPËRI: REZULTATE MBI NDIKIMIN E NDRYSHIMIT TË MOTIT DHE KLIMËS”

Elona Dushku¹, Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë
Argita Frashëri, Departamenti i Statistikave Financiare, Banka e Shqipërisë
Frenki Ktona, Departamenti i Statistikave Financiare, Banka e Shqipërisë

ABSTRAKT

Ky artikull - duke përdorur të dhënat e nivelit të ndërmarrjeve nga rasti i parë i vrojtimit “Aksesi në Financë i Ndërmarrjeve”, zhvilluar gjatë periudhës maj-qershor 2023, nga Banka e Shqipërisë - paraqet evidenca mbi situatën financiare të ndërmarrjeve në Shqipëri, si dhe perspektivën e tyre në lidhje me efektet e ndryshimit të motit dhe klimës. Të dhënat tregojnë se 14% e ndërmarrjeve në Shqipëri kanë bërë disa investime gjatë vitit 2022 për të trajtuar ndikimin e ndryshimeve të motit dhe për të përballuar procesin e reduktimit të emetimit të karbonit.

Megjithatë, pjesa më e madhe e tyre, mbi 80% e ndërmarrjeve, konfirmojnë se nuk kanë vendosur asnjë objektivi të brendshëm të monitorueshëm për emetimin e karbonit dhe konsumin e energjisë. Në përgjithësi, ndërmarrjet në Shqipëri presin që kalimi drejt një emetimi më të ulët të karbonit nuk do të ketë ndikim në kërkesën e tregut, zinxhirin e furnizimit dhe reputacionin e tyre. Rreth 1/5 e ndërmarrjeve presin që kalimi në emetim më të ulët të karbonit do të ishte një mundësi për të me ndikim pozitiv në kërkesën e tregut, zinxhirin e prodhimit dhe reputacionin, si dhe vetëm një përqindje e vogël e tyre pret që periudha e tranzicionit do të ketë ndikim negativ.

I. HYRJE

Banka e Shqipërisë gjatë periudhës maj-qershor të vitit 2023 ka zhvilluar valën e parë të vrojtimit mbi “Aksesi në financë të ndërmarrjeve në Shqipëri” fokusuar kryesisht tek SME-të, por duke përfshirë edhe ndërmarrjet e mëdha për të pasur një pamje më të plotë të situatës të gjithë ndërmarrjeve. Qëllimi i vrojtimit ishte jo vetëm për të analizuar situatën financiare të ndërmarrjeve gjatë vitit 2022, por edhe nevojat e tyre për financim, si dhe pritshmëritë që kanë këto ndërmarrje për të ardhmen.

Anketa përfshin pyetje edhe mbi ndryshimet e motit dhe të klimës në ndërmarrjet shqiptare, ku në mënyrë specifike ndërmarrjet janë pyetur në lidhje me: (i) investimet që kanë bërë dhe mund të bëjnë ndaj ndryshimeve të klimës dhe reduktimit të emetimit të karbonit, (ii) vendosjen e objektivave të brendshëm në lidhje me emetimin e karbonit dhe konsumin e energjisë, (iii) ndikimin që ndryshimet e klimës mund të kenë në ndërmarrje, (iv) efektet që tranzicioni drejt standardeve më të rrepta në mbrojtje të klimës do të ketë mbi biznesin, si dhe

¹ email: edushku@bankofalbania.org, afrashëri@bankofalbania.org, fktiona@bankofalbania.org.
Mendimet dhe qëndrimet e paraqitura në këtë material janë të autorëve dhe nuk paraqesin mendimet apo qëndrimet e Bankës së Shqipërisë.

(v) ndikimin që emetimi më i ulët i karbonit do të ketë në kërkesën e tregut, zinxhirin e furnizimit dhe reputacionin e ndërmarrjes.

Duke qenë se SME-të përbëjnë pjesën dërrmuese të ndërmarrjeve në Shqipëri (më shumë se 90% e tyre), duke punësuar 82% të totalit të të punësuarve dhe duke siguruar 74 % të vlerës së shtuar (Instat, 2023), cilësuar me të drejtë si promotorët kryesorë të rritjes, me anë të këtij vrojtimi synojmë që të mbledhim informacion më të plotë mbi to dhe problematikat dhe vështirësitë që ato paraqesin. Anketa dhe metodologjia e zgjedhjes së ndërmarrjeve në Shqipëri është bazuar në përqasjen e BQE² që zhvillon një vrojtim të tillë në vendet e BE-së dhe jo vetëm, me qëllim që mbledhja e të dhënave të bazohet në një metodologji të standardizuar duke siguruar një përcaktim të saktë të përkufizimeve për tregues të ndryshëm, si dhe mundëson një koherencë dhe krahasueshmëri të përgjigjeve në nivel ndërkombëtar.

Raundi i parë i vrojtimin iu drejtua 1221 ndërmarrjeve, të zgjedhur në mënyrë rastësore nga regjistri i ndërmarrjeve, klasifikuar në bazë të numrit të punësuarve dhe të aktivitetit ekonomik, duke përjashtuar ndërmarrjet shtetërore dhe ato në disa seksione³, si dhe duke përjashtuar ndërmarrjet që janë person fizik me një punonjës. Në total kampioni përfshinte 1,221 ndërmarrje, nga të cilat 39% janë ndërmarrje mikro, 26% të vogla, 24% mesatare dhe 12% të mëdha; me një shpërndarje sipas sektorëve përkatës: 21% e ndërmarrjeve i përkasin sektorit të industrisë, 19% sektorit të ndërtimit, 29% sektorit të tregtisë dhe 30% sektorit të shërbimeve. INSTAT ka ndërmarrë procesin e zgjedhjes së kampionit, punës në terren dhe mbledhjen e të dhënave, në formën e intervistave ballë-për-ballë.

Artikulli është i organizuar në këtë mënyrë: Pjesa e dytë trajton disa nga karakteristikat e zgjedhjes, si dhe ecurinë e disa prej treguesve gjatë 2022. Pjesa e tretë paraqet rezultatet mbi ndryshimet e klimës dhe motit, si dhe në fund të saj parashtrohen disa vërejtje përfundimtare.

² Vrojtimi i BQE (Banka Qendrore Evropiane), "Aksesi në financë".

³ Janë përjashtuar ndërmarrjet në degët A, K, O, T, U si dhe degët P dhe Q të cilat zënë një përqindje të vogël. Ndërmarrjet në bazë të numrit të të punësuarve janë ndarë në: ndërmarrje mikro (1-9 të punësuar), të vogla (10-49 të punësuar), mesatare (50-249 të punësuar), të mëdha (250+ të punësuar). Sektori i industrisë.

II. KARAKTERISTIKAT DHE GJENDJA E NDËRMARRJEVE NË 2022

Të dhënat mbi zgjedhjen finale tregojnë që pjesa dërrmuese e ndërmarrjeve kanë nga 1 deri në 9 të punësuar, i përkasin sektorit të shërbimeve dhe tregtisë, si dhe kanë xhiro vjetore më pak se 43 mijë euro (tabela 1).

Tabela 1. Karakteristikat e përgjithshme të ndërmarrjeve


Numri i të punësuarve	
1-9 të punësuar	75%
10-49 të punësuar	19%
50-249 të punësuar	5%
250+ të punësuar	1%
Sektorët	
Industri*	13%
Shërbim	42%
Ndërtim	9%
Tregti	37%
Xhiroja vjetore	
deri në 25,000 €	51%
më shumë se 25,000 € dhe deri në 43,000 €	12%
më shumë se 43,000 € deri në 220,000 €	17%
më shumë se 220,000 € deri në 500,000 €	5%
më shumë se 500,000 € dhe deri në 1 milion €	4%
më shumë se 1 milion € dhe deri në 2 milion €	2%
më shumë se 2 milionë euro dhe deri në 10 milionë euro	2%
më shumë se 10 milionë euro dhe deri në 50 milionë euro	3%
më shumë se 50 milionë euro	3%
Vjetërsia e ndërmarrjes	
10 vjet ose më shumë	36%
5 vjet ose më shumë, por më pak se 10 vjet	31%
2 vjet ose më shumë, por më pak se 5 vjet	20%
Më pak se 2 vjet	14%

Burimi: Vrojtimi "Aksesi në financim i ndërmarrjeve", BSH, 2023.

* Ku në degët e Industrisë përfshihen seksionet (B, C, D, E), Ndërtim (F), Tregti (G), dhe në Shërbime (H, I, J, L, M, N, R, S).

Në lidhje me situatën e tyre financiare të dhënat tregojnë për një rritje të treguesve si kostot e tjera, xhiroja, kostoja e punës ose të mbetur në nivel të pandryshuar si numri i punonjësve, investimet dhe inventarët (Grafiku 1). Për të dhënë një tendencë më të qartë të treguesve kemi paraqitur balancën neto për çdo tregues llogaritur si diferenca e përgjigjeve "rritur" përkundrejt atyre "ulur", pa përfshirë përgjigjet neutrale. Grafiku i balancave neto tregon se 70% e ndërmarrjeve pohojnë rritje të kostove të tjera (si energjia elektrike, materiale), kostove të punës, ndjekur nga xhiroja, fitimi, numri i punonjësve, shpenzimet e interesit (Grafiku 2). Në lidhje me shpenzimet e interesit, si dhe me borxhin përkundrejt aktiveve, pothuajse 57-59% e ndërmarrjeve vlerësojnë që janë të pazbatueshme për to.


Grafik 1. Çfarë ka ndodhur me treguesit e mëposhtëm gjatë vitit 2022, nëse janë rritur, ulur apo kanë mbetur të pandryshuar.



Burimi: Vrojtimi "Aksesi në financim i ndërmarrjeve", BSH, 2023

Shënim: Firmat janë pyetur për secilin nga treguesit, nëse ato janë rritur janë ulur apo kanë mbetur të pandryshuar gjatë vitit 2022? Të dhënat janë të peshuara.

Grafik 2. Balanca Neto për secilin nga treguesit




Burimi: Vrojtimi "Aksesi në financim i ndërmarrjeve", BSH, 2023

Shënim: Balanca neto është llogaritur si diferenca midis përgjigjeve që thonë "rritur" përkundrejt atyre që thonë "ulur", pa përfshirë pyetjet asnjëse.

Ndërsa në lidhje me problematikat kryesore gjatë vitit 2022, ndërmarrjet kanë identifikuar: konkurrencën, gjetjen e klientëve, inflacionin, kostot e prodhimit, mungesën e stafit të kualifikuar dhe taksat. Ndërsa ndër problematikat më pak të rëndësishme veçohet pandemia e shkaktuar nga Covid-19, përshtatja rregullative, lufta në Ukrainë, aksesin në financë, si dhe paqëndrueshmëria politike/krizat ekonomike (Grafiku 3). Më konkretisht, grafiku i balancave neto llogaritur si diferencë midis përgjigjeve "shumë/rëndësishëm" dhe "jo/pak i rëndësishëm" tregon që konkurrenca, gjetja e klientëve dhe inflacioni kanë qenë pengesat kryesore të ndërmarrjeve gjatë vitit 2022 (Grafiku 4).


Grafik 3. Pengesat kryesore të ndërmarrjeve



Burimi: Vrojtimi "Aksesi në financim i ndërmarrjeve", BSH, 2023

Shënim: Ndërmarrjet janë pyetur sa të rëndësishme kanë qenë problemet e mëposhtme për ndërmarrjen tuaj gjatë vitit 2022 (janar -dhjetor) ? Ju lutemi përgjigjuni nga 1-10, ku 1 do të thotë se nuk është aspak e rëndësishme dhe 10 do të thotë se është jashtëzakonisht e rëndësishme. Të dhënat janë të peshuara.

Grafik 4. Balanca neto e problematikave të ndërmarrjes



Burimi: Vrojtimi "Aksesi në financim i ndërmarrjeve", BSH, 2023,

Shënim: Balanca neto është llogaritur si diferenca midis përgjigjeve që thonë "ritur" përkundëjt atyre që thonë "ulur", pa përfshirë pyetjet asnjansë.


III. NDRYSHIMET E KLIMËS DHE MOTIT DHE NDIKIMI I TYRE NË NDËRMARRJET SHQIPTARE

Ashtu siç e përmendëm edhe më lart, ndërmarrjet janë pyetur edhe mbi ndikimet që ndryshimet e motit dhe të klimës mund të kenë mbi ndërmarrjet shqiptare. Literatura aktuale mbi rreziqet e klimës tregon se ato mund të ndahen në dy grupime kryesore: në rreziqe fizike dhe në rreziqe tranzitore (ECB, 2020). Rreziqet fizike rezultojnë nga ndikimet fizike që ndryshimet klimatike kanë në ekonomi, duke përfshirë ngjarjet ekstreme të motit, si dhe ndryshimet e sjelljes të klimës (ECB, 2020). Ndërsa rreziqet tranzitore rezultojnë nga zbatimi i standardeve të rrepta të klimës, rregulloreve dhe taksave për të detyruar tranzicionin drejt një ekonomie me nivel më të ulët të karbonit. Rreziqet fizike mund të ndahen në nëngrupe të tjera që kanë të bëjnë me: rreziqe fizike akute, të cilat lidhen me rreziqet natyrore si zjarret, stuhitë dhe përmytjet, ose rreziqet kronike që lidhen me ndryshimet afatgjata në modelet klimatike që rezultojnë në degradimin e mjedisit natyror dhe varfërimin e burimeve natyrore (ECB, 2020).

Të pyetur në lidhje me investimet e bëra gjatë vitit 2022 dhe ato që priten të bëhen gjatë tre viteve në vazhdim, të dhënat tregojnë se 14% e ndërmarrjeve në Shqipëri kanë bërë dhe presin që të bëjnë gjatë 3 viteve të ardhshme investime që marrin në konsideratë ndryshimet e klimës, si dhe ato që lidhen me reduktimin e emetimit të karbonit (Grafiku 5). Ndërkohë që 19% e ndërmarrjeve nuk kanë bërë investime gjatë vitit 2022, por kanë planifikuar që të bëjnë një të tillë gjatë tre viteve të vazhdim. Ndërsa 61% e totalit të ndërmarrjeve raportojnë që as kanë bërë dhe as nuk do të bëjnë investime gjatë 3 viteve të ardhshme. Vetëm 6% e ndërmarrjeve kanë bërë investime gjatë vitit 2022 por nuk planifikojnë të bëjnë investime të tjera gjatë tre viteve të ardhshme (Grafiku 5).

Të ndara sipas tipologjisë së ndërmarrjeve, të dhënat tregojnë që gjatë vitit 2022 më shumë investime kanë bërë ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha, përkatësisht 26% dhe 25%, ndërmarrjet e vogla (20%) dhe në fund ato mikro (12%, Grafiku 6). Ndarë sipas sektorëve, më së shumti kanë investuar ndërmarrjet në sektorin e industrisë, ku 30% e tyre pohojnë se kanë bërë investimeve gjatë vitit 2022 dhe presin të bëjnë gjatë tre viteve në vazhdim (Grafiku 7). Të dhënat tregojnë se 31% e ndërmarrjeve në sektorin e ndërtimit pohojnë se do të bëjnë më shumë investime në të ardhmen dhe pothuajse 20% e ndërmarrjeve në sektorët e tjerë parashikojnë të bëjnë investime që marrin në konsideratë ndryshimet e klimës. Vërehet që më shumë se 50% e ndërmarrjeve nuk kanë bërë dhe as nuk kanë planifikuar të bëjnë investime që të marrin në konsideratë ndryshimet klimatike (Grafiku 7).


Grafik 5. Investimet në vitin 2022 dhe planifikimi i investimeve në lidhje me ndryshimet e klimës gjatë tre viteve të ardhshme



Burimi: Vrojtimi “Aksesi në financim i ndërmarrjeve”, BSH, 2023.

Shënim: Firmat janë pyetur nëse ka bërë ndërmarrja juaj ndonjë investim gjatë vitit 2022 që trajton impaktin e ndikimeve të klimës dhe lidhet me procesin e reduktimit të emetimit të karbonit, apo ka në plan të bëjë ndonjë investim gjatë tre viteve të ardhshme? Të dhënat janë të peshuara.


Grafik 6. Investimet në vitin 2022 dhe planifikimi i investimeve në lidhje me ndryshimet e klimës dhe gjatë tre viteve të ardhshme, sipas llojit të ndërmarrjeve



Burimi: Vrojtimi “Aksesi në financim i ndërmarrjeve”, BSH, 2023.

Shënim: Firmat janë pyetur nëse ka bërë ndërmarrja juaj ndonjë investim gjatë vitit 2022 që trajton impaktin e ndikimeve të klimës dhe lidhet me procesin e reduktimit të emetimit të karbonit, ose ka në plan të bëjë ndonjë investim gjatë tre viteve të ardhshme. Të dhënat janë të peshuara.

Grafik 7 Investimet në vitin 2022 dhe planifikimi i investimeve në lidhje me ndryshimet e klimës dhe gjatë tre viteve të ardhshme, sipas sektorit të ndërmarrjeve




Burimi: Vrojtimi "Aksesi në financim i ndërmarrjeve", BSH, 2023.

Shënim: Ndërmarrjet janë pyetur nëse kanë bërë ndonjë investim gjatë vitit 2022 që trajton impaktin e ndikimeve të klimës dhe lidhet me procesin e reduktimit të emetimit të karbonit, apo nëse ka në plan të bëjë ndonjë investim gjatë tre viteve të ardhshme. Të dhënat janë të peshuara.

Në lidhje me vendosjen e objektivave të brendshëm, të monitorueshëm mbi emetimin e karbonit dhe konsumin e energjisë gjatë vitit 2023, të dhënat tregojnë se 82% e ndërmarrjeve nuk kanë vendosur ndonjë objektiv të tillë (Grafiku 8). E njëjta sjellje vërehet edhe për ndarjen e ndërmarrjeve sipas numrit të të punësuarve dhe sektorëve (Grafiku 9 dhe 10). Megjithatë evidentohet se 35-37% e ndërmarrjeve të mesme, përfshirë ato në sektorin e industrisë, kanë vendosur objektiva të brendshëm mbi emetimin e karbonit dhe konsumin e energjisë.


Grafik 8. Vendosja e objektivave të brendshëm të monitorueshëm në lidhje me emetimin e karbonit dhe konsumin e energjisë gjatë vitit 2023 për totalin e ndërmarrjeve



Burimi: Vrojtimi "Aksesi në financim i ndërmarrjeve", BSH, 2023.

Shënim: Ndërmarrjet janë pyetur nëse kanë vendosur ndonjë objektiv të brendshëm të monitorueshëm, në lidhje me emetimin e karbonit dhe konsumin e energjisë gjatë vitit 2023. Të dhënat janë të peshuara.


Grafik 9. Vendosja e objektivave të brendshëm të monitorueshëm në lidhje me emetimin e karbonit dhe konsumin e energjisë gjatë vitit 2023, sipas madhësisë në ndërmarrjes



Burimi: Vrojtimi "Aksesi në financim i ndërmarrjeve", BSH, 2023.

Shënim: Ndërmarrjet janë pyetur nëse ato kanë vendosur ndonjë objektiv të brendshëm të monitorueshëm, në lidhje me emetimin e karbonit dhe konsumin e energjisë gjatë vitit 2023. Të dhënat janë të peshuara.

Grafik 10. Vendosja e objektivave të brendshëm të monitorueshëm në lidhje me emetimin e karbonit dhe konsumin e energjisë gjatë 2023-shit, sipas sektorit të ndërmarrjeve




Burimi: Vrojtimi "Aksesi në financim i ndërmarrjeve", BSH, 2023.

Shënim: Ndërmarrjet janë pyetur nëse kanë vendosur ndonjë objektiv të brendshëm dhe të monitorueshëm, në lidhje me emetimin e karbonit dhe konsumin e energjisë gjatë 2023-shit. Të dhënat janë të peshuara.

Ndërmarrjet janë pyetur edhe mbi perceptimet që ndryshimet e klimës dhe të motit do të ndikojnë ato. Të dhënat tregojnë se pothuajse 60% e ndërmarrjeve nuk presin të ketë ndonjë ndikim, ndërsa 35% e ndërmarrjeve presin që të kenë një ndikim të vogël (Grafiku 11). Vetëm 6% e ndërmarrjeve presin që ndryshimet e klimës dhe motit të kenë një ndikim të madh për to. Perceptimi i njëjtë vërehet edhe sipas ndarjes së ndërmarrjeve sipas numrit të të punësuarve dhe sektorëve (Grafiku 13 dhe 14). Veçojmë se janë ndërmarrjet me një numër mesatar të punësuarish dhe ato në sektorin e industrisë që presin ndikimin më të madh.


Grafik 11. Ndikimi që do të ketë ndodhja e ndryshimeve të klimës në ndërmarrje totale dhe sipas numrit të të punësuarve



Burimi: Vrojtimi "Aksesi në financim i ndërmarrjeve", BSH, 2023.

Shënim: Ndërmarrjet janë pyetur në lidhje me çështjet e ndryshimit të klimës dhe të ndryshimeve të motit a mund të thoni që ndodhja e mundshme e këtyre ngjarjeve të klimës do të ketë ndikim të madh, të vogël ose nuk do të ketë ndikim në ndërmarrjen tuaj? Të dhënat janë të peshuara.

Grafik 12. Masa e ndikimit të ndryshimeve të klimës sipas sektorit të ndërmarrjeve




Burimi: Vrojtimi "Aksesi në financim i ndërmarrjeve", BSH, 2023.

Shënim: Ndërmarrjet janë pyetur në lidhje me çështjet e ndryshimit të klimës dhe të ndryshimeve të motit a mund të thoni që ndodhja e mundshme e këtyre ngjarjeve të klimës do të ketë ndikim të madh, të vogël ose nuk do të ketë ndikim në ndërmarrjen tuaj? Të dhënat janë të peshuara.

Pjesa dërrmuese e ndërmarrjeve (pothuajse 90% e tyre) perceptojnë se vendosja e standardeve më të rrepta dhe të forta ndaj klimës gjatë pesë viteve në vazhdim nuk do të ketë ndikim dhe vetëm 5% e totalit të ndërmarrjeve mendojnë që është një rrezik për biznesin. Ndërkohë 8% e totalit të ndërmarrjeve e shikojnë këtë periudhë tranzicioni si një mundësi për biznesin (Grafiku 13). Sjellje e njëjtë reflektohet edhe për ndarjet e ndërmarrjeve sipas numrit të të punësuarve dhe sektorëve (Grafiku 14 dhe 15). Ndërmarrjet mikro i shikojnë efektet e pritshme të periudhës

së tranzicionit më shumë si një mundësi për biznesin (7%) se sa si një rrezik për ta (4% e ndërmarrjeve). Për tipologjitë e tjera të ndërmarrjeve vërejmë që ky raport është pothuajse i njëjtë midis ndërmarrjeve që presin që këto efekte të tranzicionit të jenë një mundësi përkundrajt atyre që e shikojnë si rrezik (Grafiku 16). Edhe sipas sektorëve pothuajse 85% e ndërmarrjeve nuk presin që tranzicioni të ketë ndikim. Më shumë mundësi për biznesin pritet nga sektori i industrisë, ndjekur nga sektori i ndërtimit, tregtisë dhe në fund ai i shërbimeve (Grafiku 17).


Grafik 13. Efektet e pritshme të periudhës së tranzicionit në pesë vitet e ardhshme, sipas totalit dhe numrit të ndërmarrjeve



Burimi: Vrojtimi "Aksesi në financim i ndërmarrjeve", BSH, 2023.

Shënim: Ndërmarrjet janë pyetur se çfarë efekti do të prisni që tranzicioni drejt standardeve më të rrepta dhe të forta ndaj klimës do të kenë për ndërmarrjen tuaj gjatë pesë viteve në vazhdim? Të dhënat janë të peshuara.

Grafik 14. Efektet e pritshme të periudhës së tranzicionit në pesë vitet e ardhshme, sipas sektorit të ndërmarrjeve




Burimi: Vrojtimi "Aksesi në financim i ndërmarrjeve", BSH, 2023.

Shënim: Ndërmarrjet janë pyetur se çfarë efekti do të prisni që tranzicioni drejt standardeve më të rrepta dhe të forta ndaj klimës do të kenë për ndërmarrjen tuaj gjatë pesë viteve në vazhdim? Të dhënat janë të peshuara.

Ndërmarrjet janë pyetur mbi pritshmëritë për ndikimin që kalimi drejt një emetimi më të ulët të karbonit do të ketë në kërkesën e tregut, zinxhirin e prodhimit dhe reputacionin e ndërmarrjes gjatë pesë viteve në vazhdim. Përgjithësisht ndërmarrjet nuk presin që periodha e tranzicionit të ketë ndikim si në kërkesën e tregut, zinxhirin e prodhimit apo reputacionit (Grafiku 15). Megjithatë, më së shumti ndërmarrjet perceptojnë një ndikim pozitiv në secilin prej treguesve të mëposhtëm sesa një ndikim negativ.

Ky rezultat krijon perceptimin që ndërmarrjet e shikojnë periudhën e tranzicionit më shumë si një mundësi për to se sa një kosto, në terma të kërkesës së tregut, zinxhirit të prodhimit dhe reputacionit. Parë sipas numrit të të punësuarve dhe sektorëve, më së shumti janë ndërmarrjet e vogla (10-49 të punësuar) që presin ndikim pozitiv si në kërkesën e tregut, zinxhirin e prodhimit dhe reputacionin (Grafiku 16). Ndërsa në terma të sektorëve, janë ndërmarrjet në sektorët e industrisë dhe tregtisë që presin më së shumti një ndikim pozitiv nga periodha e tranzicionit (Grafiku 17).


Grafik 15. Ndikimi i tranzicionit në emetimin më të ulët të karbonit parë në aspekte të ndryshme të ndërmarrjes



Burimi: Vrojtimi "Aksesi në financim i ndërmarrjeve", BSH, 2023.

Shënim: Ndërmarrjet janë pyetur se çfarë ndikimi do të ketë kalimi drejt një emetimi më të ulët të karbonit në kërkesën e tregut, zinxhirin e prodhimit dhe në aspektet e mëposhtme të ndërmarrjes tuaj gjatë pesë viteve në vazhdim. Të dhënat janë të peshuara.

Grafik 16. Ndikimi i tranzicionit në emetim më të ulët të karbonit në aspekte të ndryshme të ndërmarrjes, sipas numrit të ndërmarrjes




Burimi: Vrojtimi "Aksesi në financim i ndërmarrjeve", BSH, 2023.

Shënim: Ndërmarrjet janë pyetur se çfarë efekti do të prisni që tranzicioni drejt standardeve më të rrepta dhe të forta ndaj klimës do të ketë për ndërmarrjen tuaj gjatë pesë viteve në vazhdim në terma të kërkesës së tregut, zinxhirit të prodhimit dhe reputacionit.

Të dhënat janë të peshuara.

Grafik 17. Ndikimi i tranzicionit në emetim më të ulët të karbonit në aspekte të ndryshme të ndërmarrjes, sipas sektorit të ndërmarrjes



Burimi: Vrojtimi "Aksesi në financim i ndërmarrjeve", BSH, 2023.
 Shënim: Ndërmarrjet janë pyetur se çfarë efekti do të prisni që tranzicioni drejt standardeve më të repta dhe të forta ndaj klimës do të ketë për ndërmarrjen tuaj gjatë pesë viteve në vazhdim në terma të kërkesës së tregut, zinxhirit të prodhimit dhe reputacionit. Të dhënat janë të peshuara.

IV. VËREJTJE PËRFUNDIMTARE

Materiali paraqet një përmbledhje të disa prej rezultateve të marra nga Anketa mbi "Aksesin në Financim të Ndërmarrjeve" në Shqipëri zhvilluar nga Banka e Shqipërisë gjatë muajve maj-qershor 2023. Fokusi kryesor i vërtimit kanë qenë kryesisht SME-të - nisur nga kontributi i rëndësishëm që ato kanë si në numër të të punësuarve, ashtu edhe në vlerë të shtuar - por pa përjashtuar ndërmarrjet e mëdha.

Vërtimi u është drejtuar 1,221 ndërmarrjeve, zgjedhur në mënyrë rastësore nga regjistri i ndërmarrjeve në Shqipëri, duke marrë në konsideratë madhësinë e tyre dhe sektorët ku ato bëjnë pjesë. Metoda e mbledhjes së përgjigjeve ishte ballë-për-ballë, realizuar nga INSTAT-i, që ishte përgjegjës për zgjedhjen e kampionit dhe punën në terren. Nga 1,221 ndërmarrje kemi marrë përgjigje nga 945 prej tyre, ndërsa pjesa tjetër refuzuan të përgjigjen ose nuk u gjendën. Përgjigjet e dhëna në këtë material janë të peshuara duke bërë të mundur që të kemi një panoramë të plotë për të gjitha ndërmarrjet në vend.

Rezultatet për vitin 2022 tregojnë se SME-të në Shqipëri janë karakterizuar nga një performancë e mirë financiare në terma të xhiros dhe fitimit, e cila duket se është zbehur disi nga rritja e kostove të energjisë, materialeve të tjera, si dhe rritja e kostos së punës. Ndër problematikat kryesore të vitit 2022, ndërmarrjet evidentojnë konkurrencën, gjetjen e klientëve dhe inflacionin.

Në lidhje me ndryshimet e klimës dhe të motit, vërejmë se ka një përpjekje për të bërë investime që i marrin në konsideratë këto ndryshime. Kështu 14% e ndërmarrjeve, të cilat kanë bërë investime gjatë vitit 2022, marrin në konsideratë ndryshimet klimatike, si dhe ato që lidhen me reduktimin e emetimit të karbonit.

Megjithatë një pjesë e konsiderueshme, rreth 61% e tyre raportojnë se nuk kanë bërë dhe nuk do të bëjnë investime edhe gjatë tre viteve në vazhdim. Në lidhje me vendosjen e objektivave të brendshëm dhe të monitorueshëm mbi emetimin e karbonit dhe konsumin e energjisë gjatë vitit 2023, të dhënat tregojnë se pjesa dërmuese e ndërmarrjeve, rreth 82% e ndërmarrjeve nuk kanë vendosur ende një objektiv të tillë.

Gjithashtu 60% e ndërmarrjeve nuk presin që ndryshimet e klimës të kenë ndikim mbi ndërmarrjet. Të pyetur se si kalimi drejt një emetimi më të ulët të karbonit do të ndikojë në kërkesën e tregut, zinxhirin e prodhimit dhe reputacionin e ndërmarrjes gjatë pesë viteve në vazhdim, përgjithësisht ndërmarrjet nuk presin që të ketë ndikim. Për më tepër, të dhënat sugjerojnë se në lidhje me ndryshimet klimatike dhe të motit, ndërmarrjet nuk presin që ato të kenë ndikim tek ndërmarrjet e tyre, dhe se kjo periudhë tranzicioni më së shumti do të jetë një mundësi për rritjen e biznesit se sa një kosto për to.

REFERENCA

Instat, (2023) "Statistikat Strukturore të Ndërmarrjeve Ekonomike"

ECB, (2024), "Survey on the Access to Finance of Enterprises in the euro area, first quarter, 2024", April 2024

ECB, (2024) "Survey on the access to finance of enterprises Methodological information on the survey and user guide for the anonymised micro dataset" J April 2024

ECB (2020), "Guide on climate-related and environmental risks supervisory expectations relating to risk management and disclosure"